



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.341/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Albert Zogaj dhe Fejzullah Rexhepi , anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.I. (Sh.) nga ... , ,Rr..., të cilin me autorizim e përfaqëson V. M. , av, nga ... , kundër të paditurit R. (.)M., nga fshati ..., Komuna e ... , me vendbanim në Danimarkë, të cilin me autorizim e përfaqëson R. Sh., av, nga ... , për shkak të vërtetimit të drejtës së pronësisë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2819/2017- datë 19.5.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 3.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2819/2017- datë 19.5.2020

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2819/2017- datë 19.5.2020 , është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit , dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Viti C.nr.30/2013 të datës 2.5.2017 , me të cilin nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të vërtetohet se është pronarë në bazë të shitblerjes, i paluajtshmërisë si ngastër kadastrale P ..., në sipërfaqe prej 273 m2 ZK ..., në vendin e quajtur ‘...’, që evidentohet në emër të paditurit R. (A.) M. Në pikën II të dispozitivit konsiderohet e tërhequr kundërpadia e të paditurit R. M. për shkak tërheqjes së kundërpadisë. Në pikën III të dispozitivit masa e përkohshme siguroese e caktuar me vendimin e gjykatës .C.nr 30/2013 të datës 12.2.2013 ,mbetet në fuqi deri në marrjen e një vendimi tjetër gjyqësor .

Në pikën III të dispozitivit obligohet paditësi që të paditurit t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 675 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në afat ligjor ka paraqitur revizion paditësi për shkak shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në bazë të nenit 215 të LPK, kjo Gjykatë ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihen ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 215 të LPK, në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Përndryshe në procedurën e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të goditur, në bazë të provave të administruara, të cilat janë vlerësuar drejt në bazë të nenit 8 të LPK, është vërtetuar se paditësi, pretendon sa ka të drejtën e pronësisë në ngastrën kadatsrale P-..., në vendin e quajtur '... ' në sipërfaqe prej 273 m² në ZK -..., të cilën e ka blerë prej të paditurit R. M., të cilën në emër të shitësit në bazë të autorizimit ka shitur F. I., ngaI padituri në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, nga fakti se autorizimi i dhënë F. I., është falsifikuar, pasi që paditësi nuk din shkrim dhe lexim, ndërsa autorizimi është nënshkruar dhe se i padituri nuk ka tjetërsuar këtë paluajtshmëri.

Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vërtetuar se nuk është vullneti shprehur i palëve kontraktuese në kuptim të nenit 2 paragrafi 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, pasi që ka munguar vullneti i shitësit, është cenuar parimi i ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë i paraparë me nenin 4 të LMD. Gjykata e shkallës së parë vlerëson se lënda e kontratës ka qenë me ngarkesë, pasi që ka qenë në posedim të personit të tretë, dhe se kontratës në fjalë i mungojnë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta dhe se kontrata nuk përmban fomën ligjore që kërkohet për tjetërsimin e paluajtshmërive.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë të vendosjes sipas ankesës së paditësit, të njëjtën e ka refuzuar si të pabazuar duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë, e çështjes , Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë mbi gjendjen faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë ,drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar .Aktgjykimi i goditur sipas vlerësimit të kësaj gjykate përmban arsye të mjaftueshme për faktet relavante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e revizionit i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit të paditësit , se të drejtën e pronësisë në ngastrën kontestuese e ka fituar në bazë të kontratës së shitblerjes në mes të paditësit si shitës dhe të paditurit si blerës e të cilin sipas autorizimit e ka përfaqësuar F. I., nuk qëndrojnë nga fakti se sipas dispozitave të nenit 36 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore , është përcaktuar *‘ Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri ‘*.Në bazë të paragrafit 2 të nenit 36 është përcaktuar *’’ Kontrata për bartjen e paluajtshmërisë duhet të lidhet me shkrim në prezenc të dy palëve në zyre kompetente’’*

Sipas dispozitave në fjalë për fitimin e drejtës së pronësisë në patundshmëri duhet të plotësohen kushtet e veçanta , të ekzistoj baza juridike , gjegjësisht puna juridike me të cilën dëshirohet të bartet pronësia e një sendi në personin tjetër , përveç bazës juridike kërkohet mënyra e fitimit (Modus Aquerendi), te sendet e paluajtshme është regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri dhe forma me shkrim e kontratës së legalizuar , e që në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e përcaktuara për fitmin e drejtës së pronësisë në ngastrën kontestuese .

Thëniet e revizionit sa i përket gjendjes faktike nuk janë vlerësuar ,pasi që revizioni në bazë të nenit 214.2 të LPK , nuk mund të paraqitet për shkak konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga arsyet e sipër përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.341/2020 datë 3 dhjetor 2020

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri